



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1081/1 të datës 13.02.2020, me pretendime për parregullsi në lidhje me shpalljen për punësim në ----- HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime kompetente në pajtim me ligjin për parandalimin e korrupsionit, për faktin se lëndën në fjalë është vepruar nga organ tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 -1081 të datës 13.10.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, është dorëzuar denoncim e regjistruar me numër 12-1081/1, me pretendime për parregullsi në lidhje me shpalljen për punësim në ----- . Pretendimet në fjalë i referohen punësimit të papërshtatshëm të stafit mësimdhënës në lidhje me shpalljen me nr.----- të publikuar më 18.12.2019 në të cilin kishte 4 vende të lira pune për mësues të diplomuar në mësimdhënie në klasë në ----- mësimi i gjuhës, nga të cilat tre ishin për "-----" dhe një për "-----" në -----.

Denoncimit i bashkëlidhet një shtojcë e denoncimit të dorëzuar, e regjistruar me numër 12-1081/2 datë 28.04.2020, me të cilën KSHPK- ja njofton për njoftimin e marrë nga Inspektorati Shtetëror Arsimit që ka vepruar sipas denoncimit të dorëzuar për rastin në fjalë për punësim jo të duhur të personelit mësimor dhe për konstatimet e konstatuara gjatë inspektimit të kryer ka përpiluar procesverbal nr. ----- dhe vendimi nr. ----- datë 21 janar 2020 me paralajmërim për heqjen e shkelleve të nenit 39 dhe 40 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme (Gazeta Zyrtare e RMV-

së nr. 161/19) drejtorit të shkollës në fjalë. Parashtruesi është pjesërisht i kënaqur me përgjigjen dhe procedurën e inspektoratit dhe gjithashtu i drejtohet KSHPK-së.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstaton se në rastin konkret bëhet fjalë për shkelje të së drejtës së marrëdhënies së punës së parashtruesit, për të cilën ka vepruar organi tjetër kompetent nga fusha - Inspektorati Shtetëror Arsimor, dhe konstatoi se bëhet fjalë për çështje pretendimesh që nuk i nënshtrohen trajtimit kompetent të saj. Prandaj, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent në lëndë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar  
Nuri Bajrami

Përgatiti: J.C.

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

